

**DEPARTEMENT
BILDUNG, KULTUR UND SPORT**
Abteilung Volksschule

Janar 2022

Informacione për kalim nga shkolla fillore e ulët (Primarschule) në shkollën fillore të lartë (Oberstufe) dhe ndërrimi i llojt të shkollës fillore të lartë brenda saj.

1. Procedura e propozimit për kalim nga shkolla fillore e ulët në shkollën fillore të lartë

Kalimi nga shkolla fillore e ulët në shkollën fillore të lartë si në shkollën Bezirk, në shkollën Sekundare dhe në shkollën Reale (Bezirks-, Sekundar- und Realschule) bëhet në bazë të propozimit nga personeli mësimor i klasës i shkollës fillore të ulët. Propozimi mbështetet nga raporti i ndërmjetëm i klasës të 6. respektivisht nga dosja vlerësuese. Aty vendosen për një gjysëmvetor dhe lëndë s'paku aq dëshmi vlerësuese (provimet, dëshmi pune, pyetësori vlerësues etj.) si është paraparë në planin mësimor për vlerësimin e një lënde, duke marrë parasysh se sa orë ka në javë lënda e caktuar. P.sh. nëse janë paraparë 4 mësimet në javë, vendosen në raportin e ndërmjetëm më s'paku katër respektivisht për vlerësim në dëftesën vjetore më s'paku tetë dëshmi vlerësuese. I mbështetur në dokumentet në dosjen vlerësuese sqaron dhe e arsyeton mësuesi i klasës propozimin e tij për kalim te prindërit dhe te nxënësja / nxënësi.

1.1 Procedura

Gjatë kalimit të gjysëmvetorit të klasës të 5. Po ashtu në gjysëmvetorin e klasës të 6. mësuesi i klasës i informon prindërit, nxënëset dhe nxënësit me gojë dhe shkrim me gjendjen e suksesit të arritur dhe përparimin në mësim të nxënësve dhe nxënësve. Me këtë tregon mësuesi i klasës se cili lloj i shkollës fillore të lartë duket më i përafërt nga sukcesi i treguar i nxënësës apo nxënësit dhe sa është e mundshme marrja e masave mbështetëse në mësim. Nëse informacionet bëhen me shkrim mund të kërkohej nga prindërit, nga nxënësja apo nxënësi një bisedë më e thelluar.

Në klasën e 6. e zhvillon mësuesi i klasës një bisedë për kalim më s'voni në kohën e paraparë nga muaji shkurt deri në prill me prindërit dhe nxënësen apo nxënësin.

Mësuesi i klasës dhe prindërit si dhe nxënësja / nxënësi e bëjnë marrveshjen e bisedës për kalim me shkrim nëse në lidhje me këtë janë dy palët të pajtimit. Nëse nuk vie deri te pajtimi i dy palëve dhe diferencat nuk mund të largohen me të gjithë pjesëmarrësit (prindërit, nxënësja/nxënësi, mësuesi i klasës) vendos zyra kompetente e komunës¹ për llojin e shkollës. Para këtij vendimi prindërit dhe nxënësja / nxënësi e kanë mundësin, që t'i paraqesin argumentet e tyre zyrës kompetente. Procedura e vendimit përfshirë dëshmitë se si ka ardhë deri te vendimi i tillë ju dërgohet në fund me shkrim prindërve dhe nxënësës / nxënësit nga zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës. Prindërit dhe nxënësja / nxënësi e kanë mundësin kundër këtij vendimi që nga dita e pranimit të ngrejne ankesë mbrenda 30 ditëve te Këshilli Rajonal i Shkollës (Schulrat des Bezirks).

¹ Këshilli i komunës mban përgjegjësinë e përgjithshme për shkollën. Me vendime zyrtare shkollore, si për shembull vendime aftësie, këshilli i komunës mund të ngarkojë një anëtar të këshillit ose drejtorinë e shkollës. Çdo komunë përcakton në një rregullore, çfarë zyre është kompetente për marrjen e vendimeve zyrtare shkollore.

2. Kushtet për kalim në shkollën Bezirk-, Sekundare dhe Reale

Te propozimi për kalim në shkollën Reale, Sekundare dhe shkollën Bezirk mësuesi i klasës i merr parasysh sukseset në lëndët kryesore dhe lëndët e tjera, vlerësimin e kompetencave vetanake si dhe prognosën e zhvillimit të nxënësve.

2.1 Kalimi në shkollën Bezirk (Bezirksschule)

Për kalim në shkollën Bezirk propozohen nxënëset dhe nxënësit të cilët në vlerësimin e raportit të ndërmjetëm të klasës të 6. në lëndët kryesore kanë rezultate të mira dhe të shkëlqyeshme ndërsa në lëndët e tjera rezultate të mira. Po ashtu duhet të lënë bindjen nxënëset dhe nxënësit se janë të pavarur, kanë aftësinë e zgjidhjeve të problemeve aftësinë e perceptimit dhe në veçanti një prognozë të mirë për qëndrimin në shkollën Bezirk.

2.2 Kalimi në shkollën (Sekundarschule)

Për kalim në shkollën Sekundare propozohen nxënëset dhe nxënësit të cilët në bazë të vlerësimit në raportin e ndërmjetëm të klasës të 6. në lëndët kryesore kanë treguar kryesisht sukses të mirë ndërsa në lëndët e tjera kryesisht sukses të mjaftueshëm. Nxënëset dhe nxënësit duhet të lënë bindjen mjaftueshëm sa i përket vetëpavarësis, aftësisë të zgjidhjes të problemeve të perceptimit dhe prognozë të mirë për të qëndruar në shkollën Sekundare.

2.3 Kalimi në shkollën Reale (Realschule)

Për kalim në shkollën Reale propozohen nxënëset dhe nxënësit të cilët sipas vlerësimit të raportit të ndërmjetëm të klasës të 6. në lëndët kryesore dhe lëndët e tjera tregojnë kryesisht sukses të mjaftueshëm.

3. Ndërrimi i llojit të shkollës në shkollën fillore të lartë (Oberstufe)

Ndërrimi i llojit të shkollës në shkollën fillore të lartë bëhet po ashtu përmes propozimit. Nxënëset dhe nxënësit me sukses shumë të mirë në lëndët kryesore mundën përmes propozimit të mësuesit të klasës që pas gjysëmvjetorit të parë të klasës në shkollën fillore të lartë pa e përsëritë vitin shkollor të kalojnë në nivelin tjetër më të lartë shkollor. Përndryshe pas çdo viti shkollor me propozimin e mësuesit të klasës është një ndërrim i llojit të shkollës i mundshëm. Ndërrimi i llojit të shkollës në një nivel më të lartë në fund të vitit shkollor është i mundshëm me apo pa përsëritje, ku ndërrimin pa përsëritje duhet ta lejoj pas vërtetimit zyra përgjegjëse për vendimin brenda komunës.

Përsëritja për arsye të mos përmbushjes të kushteve për kalim në klasën tjetër është i mundshëm vetëm në shkollën Reale. Nxënëset dhe nxënësit e shkollës Bezirk respektivisht të shkollës Sekundare të mos plotësojnë kushteve për kalim në klasën tjetër të nivelit të njëjtë shkollor vendosen direkt në llojin tjetër të nivelit më të ulët shkollor.